NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve: V.Sh., M.Sh., B.A. dhe B.B., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, A.B., për shkak të veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 par.1 të KPRK-së dhe B.A., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit B.A. dhe nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.232/2017 të datës 29.06.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.364/2018 të datës 29.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 05 qershor 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pabazuara, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.A. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.232/2017 të datës 29.06.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.364/2018 të datës 29.11.2018.

II. Pranohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, **konstatohet** se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 232/2017 të datës 29.06.2018 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 364/2018 të datës 29.11.2018, është shkelur dispozita e nenit 385 par.1 nënpar.1.4 të KPPK-së, në favor të të pandehurve V.Sh., M.Sh., B.A., A.B. dhe B.B.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.232/2017 të datës 29.06.2018, të dënuarin B.A., e ka shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite si dhe dënim plotësues ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbim publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite. I dënuari është obliguar për pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 €.

Me të njëjtin aktgjykim të pandehurit V.Sh., M.Sh., B.A. dhe B.B., janë liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe A.B., për shkak të veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, pasi që nuk është vërtetuar se kanë kryer veprat penale në fjalë.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.364/2018 të datës 29.11.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe mbrojtësit të të dënuarit B.A. kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit B.A., av. M.M., nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, i dënuari të lirohet nga akuza ose t'i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim;.

- prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që

Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, përkitazi me të pandehurit V.Sh., M.Sh., B.A. B.B. dhe A.B., pasi me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë liruar nga akuza.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe mbrojtësve të të pandehurve

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.57/2019 e datës 18.03.2019, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.A., av.Masar Morina, të refuzohet si e pabazuar, mbrojtësi i të pandehurës B.B., ka propozuar që kërkesa e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të refuzohet si e pabazuar, kurse mbrojtësit e të pandehurve V.Sh., M.Sh. dhe A.B., nuk janë përgjigjur në pretendimet e prokurorit të shtetit.

Pretendimet e paraqitura në kërkesa

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë aktgjykimi është mbështetur vetëm në dëshminë e dëshmitarit A.I. dhe transkriptet e bisedave telefonike. Pretendohet se dëshmia e dëshmitarit A.I. është marrë në kundërshtim me dispozitën e nenit 384 par.1 nënpar.1.8 të KPPK-së dhe nuk ka qenë dashur të merret për bazë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që ky person ka qenë i dënuar në lëndën tjetër penale që është zhvilluar kundër tij, për më tepër nga dëshmia e tij nuk vërtetohet se i dënuari ka dhënë ryshfet të dënuarit, por biseda është zhvilluar për pagesën e anuiteteve për leje komunale për ndërtimin e objektit.

Pretendohet se në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ka marrë para në formë ryshfeti, se në çfarë apoena janë dhënë këto para, pastaj në cilin vend dhe a ka pasur persona tjerë prezent kur janë dhënë paratë, po ashtu nuk janë dokumentuar numrat serik të parave dhe vendi se ku janë marrë përkatësisht janë dhënë paratë.

Më tutje pretendohet se nuk është vërtetuar se i dënuari ka kërkuar ryshfet dhe se nuk është theksuar se cila ishte shuma e kërkuar dhe e pranuar e parave nga ana e të dënuarit, pasi që objektit të dëshmitarit i ishin vendosur shiritat për ndalimin e ndërtimit në kuadër të kompetencave të inspektorëve të ndërtimit.

Në kërkesë të prokurorit të shtetit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për shkak se dispozitivet e aktgjykimeve janë të paqarta dhe arsyetimet nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilin aktgjykim të pandehurit janë liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, vetëm është theksuar se të pandehurit nuk kanë pasur marrëveshje paraprake mes veti me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete apo për tjetrin por në akuzë vetëm është cekur neni 31 i KPRK-së. Pretendohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me bashkëkryerje duke pasur parasysh pozitën e tyre të punës dhe atë V.Sh., drejtor në drejtorinë e urbanizmit, M.Sh. shef i inspeksionit të ndërtimit në DUPMM, B.B. inspektore e ndërtimit, së bashku kanë kontribuar në kryerjen e kësaj vepre penale.

Pretendohet se në veprimet e të pandehurve janë përmbushur elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, pasi që të njëjtit kanë qenë në dijeni se në qytetin e Gjilanit po ndërtohen shumë objekte kolektive dhe afariste në kundërshtim me Ligjin për Ndërtim 04/L-110 dhe në kundërshtim me planin zhvillimor urban ashtu që operatorëve ekonomik “A..H..”, “E..A...”, SHPK ”G..”, “T...G...”, “C...P...”, NNT “J...” dhe “Xh...D...” dhe qytetarit A.I., u kanë mundësuar që në mënyrë të pakontrolluar të vazhdojnë ndërtimet duke bërë vetëm konstatimin formal të gjendjes faktike në teren dhe vendosjen e shenjave zyrtare mbi ndalimin e vazhdimit të punimeve dhe asnjëherë nuk kanë zbatuar masën e rrënimit edhe pse kanë qenë të obliguar për një gjë të tillë. Theksohet posaçërisht fakti se ndaj përgjegjësve të firmave ndërtimore të lartëcekura është zhvilluar procedurë penale për shkak të veprës penale heqja ose dëmtimi i i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i KPRK-së dhe të cilët kanë pranuar fajësinë dhe me këtë rast Gjykata Themelore në Gjilan i ka shpallur fajtor dhe u ka shqiptuar dënim me gjobë secilit në lartësi prej nga 300 € dhe i cili aktgjykim është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë pretendohet se nuk ka qenë dashur që ti fal besim mbrojtjes së të pandehurve pasi që të njëjtit nuk kanë bërë pranimin e fajësisë, kanë mohuar në tërësi kryerjen e veprës penale dhe se vetëm kanë përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre duke theksuar se puna e tyre fillon me daljen e tyre në terren, identifikimin e objekteve në ndërtim, kërkimin e

dokumentacionit nga ana e punë kryerësve dhe varësisht prej të gjeturave bëjnë përpilimin e procesverbaleve e pastaj nga ana e shefit të shërbimit juridik përpilohet aktvendimi për ndërprerjen e punimeve me qëllim që të mos vazhdohet me punime në objektin përkatës. Në rastet e vazhdimeve të punimeve duhet që të merren masa tjera përkatësisht shiritimi i objektit dhe nëse pastaj vazhdohet me punime, atëherë bëhet shqiptimi i gjobës dhe nëse edhe pas kësaj vazhdon ndërtimi, inspektorët kopjen e vendimit e dërgojnë tek shefi i shërbimit juridik i cili merr vendim për rrënimin e objektit dhe me këtë edhe përfundon puna e inspektorëve ndërtimor duke u bazuar në kompetencat e tyre.

Bazuar në dëgjimin e dëshmitarëve dhe provat materiale të prezantuara gjatë seancave gjyqësore është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat janë liruara nga akuza nga gjykata e shkallës së parë dhe i cili aktgjykim është vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Pretendohet se të pandehurit në rastet konkrete edhe pse në terren kanë konstatuar parregullsitë e evidentuara përkatësisht faktin se operatorët ekonomik: “A...H...”, “E...A...”, SHPK ”G...”, “T...G...”, “C...P...”, NNT “J...”, “Xh...D...”, “C...C...” dhe qytetarit A.I., nuk janë pajisur me leje ndërtimi për objektet, megjithatë pos faktit se kanë konstatuar gjendjen në terren dhe kanë përpiluar vendime përkatëse për rrënim të objekteve me asnjë rast nuk kanë realizuar rrënimin dhe me këtë është vazhduar me punime ndërtimore. Në këto raste është vepruar në kundërshtim me nenin 10 të Udhëzimit Administrativ 59/2005 mbi Mënyrën e Kryerjes dhe Mbikëqyrjes Inspektive të Inspeksionit Ndërtimor, përkatësisht mënjanimin e parregullsive dhe mangësive, ndalimin e ndërtimit të mëtejshëm përkatësisht rrënimin e ndërtimit apo pjesës së tij ose kthimin në gjendjen e mëparshme si dhe të paraqes fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj pjesëmarrësve përgjegjës në ndërtim e që këto veprime nuk janë ndërmarrë nga ana e të pandehurve.

Më tutje pretendohet se duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në kërkesë është vërtetuar se në veprimet e të pandehurve V.Sh., M.Sh., B.A. dhe B.B. janë manifestuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, kurse tek i pandehuri A.B. të veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së. Aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të

dispozitave të procedurës penale dhe si pasojë e kësaj është shkel edhe ligji penal me rastin kur të pandehurit janë liruar nga akuza për këto vepra penale.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit nuk është e bazuar, kurse kërkesa e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Nuk është i bazuar pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë duke u bazuar në provë të papranueshme, pasi që nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë del se nuk është i bazuar vetëm në deklarimin e tij të dhënë në cilësi të dëshmitarit edhe pse në çështje tjetër penale është dëgjuar si i pandehur megjithatë është theksuar se aktgjykimi mbështetet vetëm në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor dhe provat materiale përkatësisht transkriptet e bisedave telefonike të zhvilluara mes të dënuarit dhe dëshmitarit, andaj me këtë rast aktgjykimi nuk është i mbështetur në provë të papranueshme pasi që deklarimi i të dëmtuarit A.I. i dhënë në çështjen penale të zhvilluar kundër tij në një rast tjetër penal nuk është marrë parasysh në çështjen ndaj të dënuarit B.A..

Në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë përshkruar në mënyrë të hollësishme të gjitha veprimet që i atribuohen të dënuarit, posaçërisht shuma e kërkuar prej 5.000 €, shuma e marrë nga i dëmtuari në shumë prej 3.000 € dhe po ashtu edhe arsyeja e kërkesës dhe marrjes së të hollave me qëllim që të dëmtuarit të mos i rrënohet një kat i ndërtimit që ishte në kundërshtim me lejen ndërtimore të objektit banesor në rrugën qarkore përballë fushës sportive "G.." në Gjilan.

Pretendimet e theksuara në kërkesë përkitazi me llojin e apoenave dhe numrin e tyre serik janë irelevante pasi që me rëndësi, siç është arsyetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është shuma e kërkuar dhe e marrë, dhe për më tepër, ishte provuar në mënyrë të qartë në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Sa i përket pretendimit të theksuar te baza e kërkesës se është shkelur ligji penal, përveç faktit se është potencuar në kërkesë, megjithatë nuk është theksuar e as arsyetuar asnjë pretendim konkret, andaj, kjo pikë e kërkesës nuk u vlerësua, bazuar në nenin 436 par.1 të KPPK-së, sepse Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve në të cilat pretendon paraqitësi i kërkesës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i bazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të pretenduara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata e shkallës së parë, në faqen e 33 të arsyetimit të aktgjykimit të saj pjesën liruese e bazon në vlerësimin e dispozitës së nenit 422 par.1 të KPRK-së, përkatësisht duke konkluduar se "*...vepra penale kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e kësaj vepre penale është i nevojshëm sigurimi për vehte ose për tjetrin çfarëdo përfitimi material apo jomaterial, shkaktimi i dëmit një personi tjetër ose seriozisht ti shkel të drejtat e një personi tjetër çka do të thotë se çdo shkelje e detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale por ajo mund të tërheqë përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit. Në rastin konkret, në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë përfituar për vehte, për dikend tjetër ose ti kenë shkaktuar dëm një personi tjetër*".

Arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë në faqen e gjashtë të aktgjykimit të saj duke theksuar se "*... me asnjë provë nuk argumentohet fakti se të akuzuarit kanë pasë marrëveshje paraprake në mes veti me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për veti apo për tjetrin...*", për të vazhduar me arsyetimin se "*... me asnjë provë nuk argumentohet fakti se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet e theksuara në akuzë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vehte*

apo operatorët ekonomik për të përfituar dobi apo për të shkaktuar dëm ndokujt respektivisht komunës dhe ky fakt jo vetëm që nuk theksohet në dispozitiv të akuzës por as nuk provohet me provat e administruara...".

Gjykata Supreme e Kosovës, me kujdes ka vlerësuar arsyetimin e paraqitur nga këndvështrimi i gjykatave të dy instancave më të ulëta, mirëpo me këtë rast vlerëson se dispozitën e nenit 422 par.1 të KPRK-së duhet analizuar në lidhje me mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale.

Me këtë rast të rëndësishme janë të përcaktohen komponentët e kësaj vepre penale:

- së pari se të pandehurit a kishin cilësinë e personave zyrtar;
- a kishin tejkaluar apo nuk i kishin përmbushur detyrat e tyre zyrtare dhe
- përcaktimi i qëllimit të tyre që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër përkatësisht që ti shkaktoj dëm personit tjetër apo seriozisht ti shkel të drejtat e tij.

Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të tri komponentët e kërkuara sipas dispozitës ligjore të nenit 422 par.1 të KPRK-së në rastin konkret ishin përmbushur në mënyrë kumulative dhe atë së pari nuk ishte kontestuese edhe sipas pikpamjes së gjykatave të instancave më të ulëta se të gjithë të pandehurit kishin cilësinë e personave zyrtar (siç përcakton dispozita e nenit 120 par.2 të KPRK-së), pasi që i pandehuri V.Sh. ishte person i emëruar drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit në Kuvendin Komunal të Gjilanit, kurse të pandehurit e tjerë M.Sh., B.A. dhe B.B., ishin persona të zgjedhur i pari shef kurse dy të tjerët inspektor komunal në drejtorinë e Urbanizmit në Kuvendin Komunal të Gjilanit.

Mirëpo kontestuese sipas interpretimit të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë ishin dy aspektet e tjera dhe atë tejkalimi përkatësisht mos përmbushja e detyrave zyrtare dhe qëllimi i përfitimit të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër përkatësisht shkaktimi i dëmit personit tjetër apo seriozisht shkelja e të drejtave të tij.

Megjithatë me qëllim të shmangies së interpretimeve të ndryshme dhe heqjes së dilemave ligjvënësi, qartësisht me dispozitën e nenit 422 par.2 të KPRK-së ka përcaktuar por pa u kufizuar në disa nga format e shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe po ashtu edhe formën e theksuar në

paragrafin 2 duke përcaktuar se "*moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj*". Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës përmes kësaj dispozite del se të pandehurit nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre të përcaktuara me Ligjin për Ndërtim 04/L-110 përkatësisht nenin 10 të Udhëzimit Administrativ 59/2005 mbi Mënyrën e Kryerjes dhe Mbikqyrjes Inspektive të Inspeksionit Ndërtimor. Nuk janë kontestuese faktet se të pandehurit kanë ndërmarrë veprime të identifikimit të ndërtimeve pa leje, vendosjen e shiritave për ndërprerjen e punimeve ndërtimore por nuk kanë vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve që do të kishin bërë rikthimin e gjendjes së mëparshme përkatësisht rrënimin e tyre dhe me këtë vërtetohet edhe moskryerja e detyrave të përcaktuara me ligj.

Sa i përket aspektit të tretë përkatësisht qëllimit të të pandehurve që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër përkatësisht që ti shkaktoj dëm personit tjetër apo seriozisht ti shkel të drejtat e tij, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrat e kryerjes së kësaj vepre penale në formë alternative. Mirëpo duke u bazuar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë qartazi është përshkruar se të pandehurit *"...me qëllim që vetit apo të tjerëve të u sjellin dobi të kundërligjshme pasurore dhe konkrtetisht operatorëve ekonomik*: *"A..H..", "E...A...", SHPK "G...", "T...G...", "C...P...", NNT "J...", "Xh...D...", "C...C..." dhe qytetarit A.I., ashtu që u kanë mundësuar investitorëve të pandërgjegjshëm të ndërtojnë në mënyrë të pakontrolluar dhe permanente pa u penguar fare...*". Me këtë rast pa asnjë dyshim del se operatorët ekonomik të potencuar më lartë kanë pasur dobi pasurore të kundërligjshme pasi që kanë vazhduar ndërtimin e objekteve të tyre të banimit kolektiv. Dispozitën e nenit 422 par.1 të KPRK-së, duhet interpretuar në atë mënyrë që për tu kryer kjo vepër penale nuk është e domosdoshme përfitimi përkatësisht shkaktimi i dëmit, por kufiri i përgjegjësisë penale është dukshëm më i gjerë dhe inkriminon vetëm qëllimin për përfitim përkatësisht për të shkaktuar dëm përmes kryerjes së veprës penale dhe këtë logjikë të interpretimit duhet ndjekur edhe në rastin konkret, pasi që edhe vet dispozita ligjore nuk ka përcaktuar shprehimisht vlerën e dobisë së përfituar por e rëndësishme është vetëm të ketë qëllim për përfitim pasuror e që në rastin konkret nuk ka ekzistuar vetëm qëllimi, mirëpo ky është materializuar meqë është e qartë se përfitimi ka ekzistuar tek operatorët ekonomik meqë të njëjtit nuk kanë pagur për lejet e ndërtimit sipas tarifave të përcaktuara komunale dhe punën e kanë vazhduar, sepse objekti nuk është rrënuar.

Sa i përket manifestimit të dashjes së drejtpërdrejt për përfitim, Gjykata Supreme e Kosovës, vëren se arsyetimet e theksuara në aktgjykimet nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta janë mjaft të gjera në interpretim të përgjegjësisë penale edhe pse është e qartë se vepra penale në fjalë kryhet vetëm me dashje direkte. Dispozita e nenit 21 par.2 i KPRK-së, ka përcaktuar se *"Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj*", kurse neni 22 i KPRK-së po ashtu thekson se " *Dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike*", ashtu që, dashja si element subjektiv i veprës penale duhet të vlerësohet bazuar në rrethanat objektive të veprimeve të të pandehurve dhe duke u bazuar në veprimet konkrete të tyre të arrihet konkludimi se a manifestohen apo jo elementet e kësaj vepre penale e posaçërisht dashja direkte e tyre. Të pandehurit paraprakisht ishin të caktuar në detyrat e punës së tyre si drejtor i urbanizmit (V.Sh.), shef i inspekcionit (M.Sh.) dhe inspektorët komunal të ndërtimit (B.A. dhe B.B.) dhe qëndron fakti se kishin bërë konstatimet në terren përmes procesverbaleve duke evidentuar ndërtimet pa leje ndërtimore dhe po ashtu kishin ndërmarrë edhe hapa tjerë në drejtim të ndaljes së ndërtimeve, mirëpo me asnjë rast të vetëm nuk kishin bërë rrënimin e objekteve të evidentuara pa leje të ndërtimit dhe përmes kësaj kishin manifestuar dashjen e tyre për kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Nga rrethanat faktike mund të nxjerrët konkludim se të pandehurit ishin të vetëdijshëm se ndërtimet te operatorët ekonomik "Agro Hermes", "Erti Ashensor", SHPK "Gazi", "Trade Group", "City Project", NNT "Jaha", "Xhevda Dekor", "Ceni Com" dhe qytetarit Avdyl Islami kishin filluar pa leje ndërtimore dhe po vazhdonin dhe veprimet e tyre ishin të natyrës formale, siç theksohet edhe në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk e akcepton arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të aprovuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me arsyetimin e dhënë në faqen e 33 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ku është theksuar se "*...çdo shkelje e detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale por ajo mund të tërheqë përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit.*". Është e kuptueshme që ekziston një ndarje mes të përgjegjësisë penale dhe asaj disiplinore dhe kjo duhet vlerësuar në prizmin e qëllimit të të pandehurve, megjithatë në rastin konkret përgjegjësia penale duhet të ndërlidhet me qëllimin e kryerësit dhe i cili qëllim të manifestohet përmes veprimeve konkrete, kurse te përgjegjësia disiplinore manifestohet përmes

neglizhencës në ushtrimin e detyrës zyrtare mirëpo pa pasur qëllim përfitimin përkatësisht shkaktimin e dëmit. Në rastin konkret sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, qëllimi është manifestuar përmes mos ushtrimit të detyrës zyrtare dhe e cila ka pasur për pasojë përfitimin e operatorëve ekonomik pasi që të njëjtit kanë vazhduar me punime ndërtimore pa u pajisur me leje përkatëse ndërtimore.

Gjykata e shkallës së parë në pjesën liruese të aktgjykimit të saj e arsyeton mosveprimin e të pandehurve për mos rrënimin e objekteve me faktin se në ndërkohë janë pajisur me leje ndërtimore (duke u besuar në tërësi mbrojtjes së të pandehurve) e të cilin arsyetim e pranon në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë.

Mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoj se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurve në harmoni me provat e tjera të administruara, për më tepër, nuk ka vlerësuar edhe shpërputhjet mes mbrojtjes së të pandehurve e posaçërisht versionin e mbrojtjes së të pandehurit V.Sh. dhe M.Sh. përkitazi me pajisjen me leje ndërtimore të operatorëve ekonomik. Në faqen 21 të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është konstatuar fakti se i pandehuri V.Sh., ka theksuar "V*endimet për rrënim nuk janë zbatu, për shkak se këto subjekte kanë marrë leje për ndërtim*", kurse i pandehuri tjetër M.Sh. në faqen 22 të po këtij aktgjykimi në mbrojtjen e tij ka theksuar faktin se "*Të gjitha këto objekte kanë qenë në procedurë për marrjen e lejes ndërtimore*.", ashtu që me këtë rast gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur që këto dy deklarime tërësisht kontradiktore ti sqaroj dhe ti arsyetoj në dritën e provave tjera të administruara.

Përveç kësaj duke u bazuar në shkresat e lëndës del se operatori ekonomik "A...H...", i cili dy muaj pas konstatimit se nuk posedonte leje ndërtimi bazuar në procesverbalin për inspektim të datës 29.09.2015 në ndërkohë ishte pajisur me leje ndërtimore të evidentuar me nr.07-350-108114 të datës 20.11.2015 si dhe qytetari A.I., i cili posedonte leje ndërtimi të evidentuar me nr.07-5719-471 të datës 09.12.2010, për objektin B+P+2 e që kishte bërë mbindërtimin e katit të katërt pa leje ndërtimore. Kurse operatorët e tjerë ekonomik "E..A..", SHPK "G...", "T...G...", "C..P..", NNT "J..", "Xh...D...", "C..C..", bazuar në shkresat e lëndës nuk është evidentuar se kanë pasur leje ndërtimore edhe pse rezulton se kanë filluar procedurën për tu pajisur me leje ndërtimore, dhe për më tepër, nuk e kanë ndalur punimet ndërtimore, andaj

arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i aprovuar nga gjykata e shkallës së dytë është i paqartë se prej nga ka rezultuar konstatimi se operatorët ekonomik posedojnë leje ndërtimore për vazhdimin e punimeve dhe se më vonë janë pajisur me leje ndërtimore dhe kjo ka qenë arsyeja e mos rrënimit të tyre. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se edhe sa i përket të pandehurit A.B. në rastin konkret janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, pasi që siç ishte përshkruar në dispozitivin e gjykatës së shkallës së parë me datë dhe vend kishte kryer veprën penale në fjalë.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë, u vërtetua se janë shkelur dispozitat e ligjit penal në favor të të pandehurve dhe kjo Gjykatë vetëm e konstaton këtë shkelje, duke mos e prekur vendimin e formës së prerë në raport me të pandehurit.

Nga këto arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.78/2019, më 05 qershor 2019

B.profesionale,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka